| 26 | 6312/12<br>“Jella dhe të tjerë k. Shqipërisë”  | Sabri Jella <sup>19</sup><br>Zana Jella<br>Ema Jella<br>Hasan Jella <sup>20</sup><br>Eleen Jella (Yella)<br>Bernice Jella (Yella)<br>Mary (Jella) Mc Dermott                                                                                                                            |
| 27 | 9217/12<br>“Jella dhe të tjerë k. Shqipërisë”  | Sabri Jella <sup>21</sup><br>Zana Jella<br>Ema Jella<br>Hasan Jella <sup>22</sup><br>Hysni Jella<br>Eleen Jella<br>Bernice Jella                                                                                                                                                        |

<sup>12</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Femi Tigani dhe Demir Tigani.

<sup>13</sup> Nevzat Gorani vdiq pas paraqitjes së kërkesës dhe kërkesit nuk paraqitën ndonjë dëshmi trashëgimie brenda afatit për shpërblimin e drejtë por I ruhet e drejta të sigurojnë një dëshmi trashëgimie e ta paraqesin atë sa më shpejt pranë Gjykatës.

<sup>14</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Valbona Baqaj, Vjollca Rexhepi dhe Flutura Sokoli.

<sup>15</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Shpetim Llagami, Eshref Llagami, Blend Llagami, Ismail Llagami, Apostolia Llagami, Marcio Llagami dhe Ana Llagami.

<sup>16</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Adem Maci dhe Ondina Karabeci.

<sup>17</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Hajten Meta, Fatmir Golia, Edmond Golia dhe Alben Golia.

<sup>18</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Viktor Tosku, Bardhe Tosku, Kol Tosku dhe Rexhina Tosku, më 28 gusht 2014, z. Zef Tosku, z. Edmir Merlika, znj Eva Tosku, z. Vili Tosku, znj. Angela Saal, znj. Kristina Tosku dhe znj. Gjele Tosku shprehën vullnetin e tyre për t'u bërë pjesë e aplikimit si trashëgimtarë të së njëjtës pjesë prone.

<sup>19</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

<sup>20</sup> Vdekur.

<sup>21</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

<sup>22</sup> Vdekur.



|    |                                                     |                                                                                                                                                                        |
|----|-----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                                     | Mary (Yella) Mc Dermott                                                                                                                                                |
| 28 | 9218/12<br>“Jella dhe të tjerë k. Shqipërisë”       | Sabri Jella <sup>23</sup><br>Zana Jella<br>Ema Jella                                                                                                                   |
| 29 | 11629/12<br>“Jella dhe të tjerë k. Shqipërisë”      | Zana Jella<br>Sabri Jella <sup>24</sup><br>Ema Jella<br>Hasan Jella <sup>25</sup><br>Eleen Jella<br>Bernice Jella<br>Hysni Jella (Karapici)<br>Mary (Yella) Mc Dermott |
| 30 | 21447/12<br>“Eqimi jatra dhe Cika k. Shqipërisë”    | Dhimitraq Eqimijatru<br>Kleri Cika <sup>26</sup><br>Gabriel Eqimijatru<br>Petri Eqimijatru                                                                             |
| 31 | 21527/12<br>“Benusi k. Shqipërisë”                  | Julian Benusi<br>Valeria Benusi<br>Anton Benusi                                                                                                                        |
| 32 | 21529/12<br>“Vrioni dhe La Francesca k. Shqipërisë” | Valeria Vrioni<br>Gherardo La Francesca<br>Oliver Vrioni<br>Dario La Francesca                                                                                         |
| 33 | 21532/12<br>“Vrioni k. Shqipërisë”                  | Oliver Vrioni                                                                                                                                                          |
| 34 | 21599/12<br>“Vrioni dhe të tjerë k. Shqipërisë”     | Oliver Vrioni<br>Valeria Vrioni<br>Gherardo La Francesca<br>Dario La Francesca<br>Nevin Godo Vrioni<br>Age Vrioni<br>Alan Vrioni                                       |
| 35 | 21675/12<br>“Poiani k. Shqipërisë”                  | Orhan Poiani                                                                                                                                                           |
| 36 | 30941/12<br>“Poiani k. Shqipërisë”                  | Lavdiye Kalasa (Poiani)                                                                                                                                                |
| 37 | 33619/12<br>“Melo k. Shqipërisë”                    | Andon Melo<br>Reno Melo                                                                                                                                                |
| 38 | 45721/12<br>“Rexho k. Shqipërisë”                   | Grigor Rexho                                                                                                                                                           |
| 39 | 47797/12<br>“Sahatci dhe të tjerë k. Shqipërisë”    | Kostaq Sahatci <sup>27</sup><br>Alberto Laca<br>Laura Laca<br>Antigoni Hoxha<br>Dhoksi Sahatci<br>Klajdi Sahatci<br>Aurora Sahatci                                     |

<sup>23</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

<sup>24</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

<sup>25</sup> Vdekur.

<sup>26</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.

<sup>27</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Etleva Sahatci, Emilia Sahatci dhe Doris Andoni Sahatci.



|    |                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|----|------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 40 | 47807/12<br>Kondi k. Shqipërisë <sup>28</sup>        | Emilia Sahatçi (Kondi)<br>Luiza Dhamo (Kondi)                                                                                                                                                                                                                          |
| 41 | 47825/12<br>“Myrteza dhe të tjerë k. Shqipërisë”     | Liri Née Myrteza<br>Rexhep Myrteza<br>Enver Dibra<br>Ylli Dibra<br>Adrian Voilla<br>Edlena Ahmetaj (Voilla)<br>Xhoana Myslim (Dibra)<br>Enton Dibra<br>Fatime Dibra<br>Kozma Voilla <sup>28</sup>                                                                      |
| 42 | 48173/12<br>“Ligori k. Shqipërisë”                   | Klaudio Ligori <sup>29</sup>                                                                                                                                                                                                                                           |
| 43 | 48401/12<br>“Derhemi dhe të tjerë k. Shqipërisë”     | Hyrije Derhemi (Duka)<br>Arsed Bodinaku<br>Liljana Liku (Mezini)<br>Nazmi Derhemi<br>Ardjan Derhemi<br>Lirie Derhemi<br>Besnike Ndoni<br>Semiha Lluqi (Derhemi)<br>Qamile Llaci <sup>30</sup> (Derhemi)<br>Bedrije Lici<br>Iglimona Kalaja (Derhemi)<br>Ridian Derhemi |
| 44 | 50791/12<br>“Stavri k. Shqipërisë”                   | Jorgji Stavri<br>Maksim Sinemati<br>Gezim Sinemati                                                                                                                                                                                                                     |
| 45 | 53998/12<br>“Shëmbitraku k. Shqipërisë”              | Ajet Shëmbitraku                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 46 | 54729/12<br>“Nishe dhe të tjerë k. Shqipërisë”       | Petraq Nishe<br>Irin Shkurti (Nishe)<br>Ilia Çili<br>Margarita Tola (Çili)<br>Sotir Çili                                                                                                                                                                               |
| 47 | 65797/12<br>“Vaqarri dhe Bakiu k. Shqipërisë”        | Sherjar Vaqari<br>Gazmend Bakiu<br>Ida Peni <sup>31</sup>                                                                                                                                                                                                              |
| 48 | 74866/12<br>“Majuni k. Shqipërisë”                   | Fatmir Majuni                                                                                                                                                                                                                                                          |
| 49 | 74867/12<br>“Eqimi Jatra dhe të tjerë k. Shqipërisë” | Dhimitraq Eqimijatru<br>Kleri Cika <sup>32</sup><br>Gabriel Eqimijatru<br>Petr Eqimijatru                                                                                                                                                                              |
| 50 | 4692/13<br>“Marku k. Shqipërisë”                     | Zamira Marku, Née Daja                                                                                                                                                                                                                                                 |

<sup>28</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Adrian Voilla dhe Edlena Ahmetaj (Voilla).

<sup>29</sup> Më 15 gusht 2014 kërkuar paraqiti një kërkesë që dhe i vëllai t'i bashkohej shqyrtimit pranë GJEDNJ-së.

<sup>30</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Ilir Llaci, Kosta Llaci, Nexhmi Llaci dhe Ruzhdi Llaci.

<sup>31</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Fation Peni dhe Musa Peni.

<sup>32</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.



|    |                                                  |                                                                                                                                                                                                      |
|----|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 51 | 64182/13<br>“Luga dhe të tjerë k. Shqipërisë”    | Dashmir Luga <sup>33</sup><br>Sanije Hyskaj<br>Hysen Tepelena<br>Gezim Luga<br>Hajrie Nallbani<br>Hysen Luga<br>Jusuf Fani<br>Prandvera Kalaci <sup>34</sup> (Luga)<br>Dilaver Tepelena              |
| 52 | 26412/14<br>“Gega k. Shqipërisë”                 | Ymer Gega                                                                                                                                                                                            |
| 53 | 30096/14<br>“Spahiu dhe të tjerë k. Shqipërisë”  | Kujtim Spahiu<br>Lumnani Spahiu<br>Sanije Bilalaj (Spahiu)<br>Manushaqe Mena (Spahiu)<br>Bukurije Gjoka (Spahiu)<br>Sose Kastrati (Spahiu)<br>Nuhi Spahiu<br>Rahit Spahiu<br>Fillanza Cengu (Spahiu) |
| 54 | 39836/14<br>“Pinari k. Shqipërisë”               | Ylvije Pinari                                                                                                                                                                                        |
| 55 | 44461/14<br>“Kaba k. Shqipërisë”                 | Liri Kaba                                                                                                                                                                                            |
| 56 | 48714/14<br>“Kasmi k. Shqipërisë”                | Abdulla Kasmi                                                                                                                                                                                        |
| 57 | 55175/14<br>“Arbana k. Shqipërisë”               | Ali Arbana <sup>35</sup>                                                                                                                                                                             |
| 58 | 57161/14<br>“Llagami dhe të tjerë k. Shqipërisë” | Ferit Llagami<br>Nusret Llagami<br>Razije Manhasa<br>Nezahet Hoxha<br>Bukurije Gjonaj<br>Emine Themeli<br>Liliana Llagami<br>Altin Llagami<br>Letfije Llagami<br>Indrin Llagami<br>Andri Llagami     |
| 59 | 57229/14<br>“Gjadri dhe të tjerë k. Shqipërisë”  | Egon Gjadri <sup>36</sup><br>Lejla Muça                                                                                                                                                              |
| 60 | 58130/14<br>“Vorpsi k. Shqipërisë”               | Ismet Vorpsi<br>Seit Vorpsi<br>Myzejen Erebara                                                                                                                                                       |
| 61 | 63020/14<br>“Gjadri k. Shqipërisë”               | Egon Gjadri <sup>37</sup>                                                                                                                                                                            |
| 62 | 66622/14                                         | Ismete Shehi                                                                                                                                                                                         |

<sup>33</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Mehriban Luga, Edlira Luga dhe Gentian Luga.

<sup>34</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Mirvana Kadiu, Arben Kalaci, Lauresha Kapidani dhe Arnela Lila.

<sup>35</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Lirije Arbana, Evis Bajo dhe Valbona Dajzmaili.

<sup>36</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Ikbale Gjadri dhe Ervin Gjadri.

<sup>37</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Ikbale Gjadri dhe Ervin Gjadri.



|    |                                                     |                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|----|-----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    | “Shehi dhe të tjerë k. Shqipërisë”                  | Ermira Shehi<br>Endrit Shehi<br>Eliana Shehi<br>Arkan Shehi                                                                                                                                                                                                      |
| 63 | 72752/14<br>“Karaosmani dhe të tjerë k. Shqipërisë” | Shazivar Karaosmani<br>Anita Alicka<br>Shegushe Kosova                                                                                                                                                                                                           |
| 64 | 72770/14 “Tela k. Shqipërisë”                       | Bulent Tela<br>Anita Alicka<br>Shegushe Kosova<br>Edmond Tela<br>Agron Tela<br>Nesfije Selenica<br>Lavdiye Kalasa<br>Teuta Fora<br>Nebi Sefa<br>Hajali Ypi<br>Xhaneta Prodan<br>Suhela Libohova<br>Gjerak Karauskaj<br>Felatun Karauskaj<br>Shazivar Kalraosmani |
| 65 | 72779/14<br>“Kosova k. Shqipërisë”                  | Ali Kosova<br>Astrit Permeti<br>Arjan Permeti<br>Aida Podgorica<br>Sokol Kosova<br>Shqipe Kosova<br>Ermira Hydi                                                                                                                                                  |
| 66 | 74962/14<br>“Myshketa dhe të tjerë k. Shqipërisë”   | Sara Myshketa<br>Agron Myshketa<br>Suzana Myshketa<br>Hasan Myshketa<br>Kujtim Myshketa<br>Aishe Shehu<br>Teuta Gjezi (Myshketa)<br>Lejla Kodra (Myshketa)<br>Verusha Kurani (Myshketa)<br>Emine Petrela (Myshketa)                                              |
| 67 | 510/15<br>“Cani dhe të tjerë k. Shqipërisë”         | Ilirian Cani<br>Enrieta Vozga (Cani)<br>Nadire Bacelli (Cani)<br>Emin Shijaku<br>Myzejen Murthi <sup>38</sup> (Cani)<br>Haxhi Cani<br>Arben Cani<br>Albana Thodhori (Cani)<br>Merita Toska                                                                       |
| 68 | 551/15<br>“Axha dhe Heba k. Shqipërisë”             | Petro Axha<br>Jolanda Axha<br>Vlash Heba<br>Aurel Heba                                                                                                                                                                                                           |
| 69 | 3082/15<br>“Eqimi Jatru dhe Cika k. Shqipërisë”     | Dhimitraq Eqimijatru<br>Kleri Cika <sup>39</sup><br>Gabriel Eqimi Jatru<br>Petri Eqimi Jatru                                                                                                                                                                     |
| 70 | 6543/15<br>“Koxhaj k. Shqipërisë”                   | Aferdita Koxhaj<br>Genc Koxhaj                                                                                                                                                                                                                                   |

<sup>38</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Ismail Murthi dhe Fatlinda Struga.

<sup>39</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.



|    |                                     |                                                                                                                                                                                                                |
|----|-------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|    |                                     | Andrea Koxhaj                                                                                                                                                                                                  |
| 71 | 6613/15<br>“Koxhaj k. Shqipërisë”   | Aferdita Koxhaj                                                                                                                                                                                                |
| 72 | 10728/15<br>“Lelo k. Shqipërisë”    | Elton Lelo<br>Gigi (Haxhire) Lelo<br>Helda Rock (Lelo)                                                                                                                                                         |
| 73 | 11214/15<br>“Dibra k. Shqipërisë”   | Ndricim Dibra<br>Vjollca Mesi<br>Amir Dibra                                                                                                                                                                    |
| 74 | 12394/15<br>“Picari k. Shqipërisë”  | Asllan Picari<br>Xhumaje Hajdari (Picari)<br>Xhemal Picari<br>Fatime Aliu (Picari)                                                                                                                             |
| 75 | 21648/15<br>“Kërcani k. Shqipërisë” | Shpresa Kercani<br>Nuri Kercani<br>Luljeta Kercani                                                                                                                                                             |
| 76 | 21704/15<br>“Meneri k. Shqipërisë”  | Hamid Meneri<br>Tahir Meneri <sup>40</sup><br>Pranvera Reci<br>Aferdita Saraci<br>Luljana Llagami <sup>41</sup><br>Reshat Meneri<br>Luan Meneri<br>Suzana Tafaj<br>Dhurata Reci<br>Ilir Meneri<br>Betina Xhepa |
| 77 | 8789/15<br>“Kapidani k. Shqipërisë” | Mas-Har Kapidani<br>Isuf Kapidani<br>Meleqe Daja (Kapidani)                                                                                                                                                    |

<sup>40</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Anila Agaraj Meneri dhe Eneida Janku Meneri.

<sup>41</sup> Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tyre: Bledar Llagami dhe Etleva Beliu.



**VENDIM**  
**Nr. 32, datë 20.1.2021**

**PËR KRYERJEN E PARAPAGIMIT TË DOZAVE TË VAKSINAVE DHE TË PAGESAVE PÛRKATËSE, QË RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E NËNSHKRUAR PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN, NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE LIGJIN NR. 3/2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”; të aktit normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik”, të miratuar me ligjin nr. 3/2021, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kryerjen nga Instituti i Shëndetit Publik të:

a) parapagimit të dozave të vaksinave anti-COVID-19;

b) pagesave përkatëse, si kostot për transportin, ruajtjen, magazinimin, shpërndarjen, përdorimin në popullatë të vaksinës dhe fushatën e vaksinimit.

2. Pagesat e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, të kryhen sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin, ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar me aktin normativ nr. 3, datë

18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, dhe me ligjin nr. 3/2021.

3. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në programin “Shërbime të shëndetit publik”, t’i shtohet fondi në shumën e përcaktuar në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Fondi sipas pikës 3, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

5. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

**URDHËR**  
**Nr. 2, datë 21.1.2021**

**PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 28 dhe të nenit 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 56, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; të urdhrit nr. 39, datë 5.2.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Komisionit të Prokurimit Publik”,

**URDHËROJ:**

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Komisionit të Prokurimit Publik, znj. Irma Droboniku, Sekretar i Përgjithshëm, për të gjitha procedurat e prokurimit publik.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data 21.1.2021 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij urdhri.



4. Delegimi i kompetencave botohet në Fletoren Zyrtare ose në Buletinin e Njoftimeve Publike.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
Jonaid Myzyri

**URDHËR**  
**Nr. 40, datë 22.1.2021**

**PËR PËRDITËSIMIN E URDHËRIT TË**  
**MINISTRIT NR. 72, DATË 2.3.2017, “PËR**  
**MIRATIMIN E LËNDËVE VEPRUESE NË**  
**PËRMBAJTJE TË PMB-ve”,**  
**TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe të nenit 19, pika 5, të kreut V, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,

**URDHËROJ:**

1. Në urdhrin e ministrit nr. 72, datë 2.3.2017, “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, të ndryshuar, bëhet përditësimi, me ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

a) rinovohen regjistrimet për 2 (dy) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

b) zgjaten afatet e regjistrimit për 55 (pesëdhjetë e pesë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

c) hiqet 1 (një) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri;

ç) kalojnë nga lista 2 tek lista 1, 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) lëndë vepruese, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ky përditësim të pasqyrohet në dokumentet e regjistrimit të PMB-ve, të regjistruara.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Milva Ekonomi**

1. RINOVHET REGJISTRIMI (RIREGJISTRIMI) PËR LËNDËT VEPRUESE, SI MË POSHTË:

1. Kieselgur (diatomaceous earth) deri 31 janar 2036.

2. Etoxazole, deri 31 janar 2028.

2. ZGJATEN AFATET E REGJISTRIMIT PËR LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

- Deri më 31 dhjetor 2021:

1. Paraffin oil

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2024:

1. Adoxophyes orana granulovirus

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 korrik 2024:

1. Quinmerac

2. Zinc phosphide

3. Orange oil

4. Tembotrione

5. Spirotetramat

6. Sodium silver thiosulfate

7. Prosulfuron

Gjithsej: 7 lëndë vepruese.

- Deri më 31 gusht 2024:

1. 6-benzyladenine

2. Dodine

3. Tau-fluvalinate

4. Bupirimate

5. 1-decanol

6. Isoxaben

7. Fluometuron

8. Sintofen

9. Azadirachtin

10. Lime sulphur

11. Aluminium sulfate

12. Tebufenozide

13. Dithianon

14. Hexythiazox

15. Flutriafof

Gjithsej: 15 lëndë vepruese.

- Deri më 30 shtator 2024:

1. Amisulbrom

2. S-abscisic acid

3. L-ascorbic acid

4. Spinetoram

5. Valifenalate

6. Thiencarbazone

Gjithsej: 6 lëndë vepruese.

- Deri më 30 nëntor 2024:

1. Emamectin



2. Pendimethalin
3. Flubendiamide
4. Ipconazole

5. Acequinocyl

Gjithsej: 5 lëndë vepruese.

- Deri më 31 dhjetor 2024:

1. Candida oleophila strain O

2. Paecilomyces fumosoroseus strain FE 9901

3. Chlorantraniliprole

Gjithsej: 3 lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2025:

1. Pseudomonas sp. strain DSMZ 13134

2. Aureobasidium pullulans (strains DSM 14940

and DSM 14941)

3. Pyriofenone

4. Imazamox

Gjithsej: 4 lëndë vepruese.

- Deri më 30 prill 2025:

1. Benalaxyl-M

2. Pyroxsulam

Gjithsej: 2 lëndë vepruese.

- Deri më 31 maj 2025:

1. Fluxapyroxad

2. Bixafen

3. Sedaxane

4. Penflufen

5. Penthiopyrad

Gjithsej: 5 lëndë vepruese.

- Deri më 30 qershor 2025:

1. Pyridalyl

2. 1,4-dimethylnaphthalene

Gjithsej: 2 lëndë vepruese.

- Deri më 31 gusht 2025:

1. Bacillus pumilus QST 2808

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 dhjetor 2025:

1. Streptomyces lydicus strain WYEC 108

Gjithsej: 1 lëndë vepruese.

- Deri më 31 janar 2026:

1. Disodium phosphonate

2. Potassium phosphonates

Gjithsej: 2 lëndë vepruese.

TOTALI: 55 (pesëdhjetë e pesë) lëndë vepruese.

### 3. HIQEN LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. Mancozeb. Të kryhet çregjistrimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve që përmbajnë mancozeb, brenda datës 4 korrik 2021.

Gjithsej: 1 (një) lëndë vepruese.

### 4. KALOJNË NGA LISTA 2 TEK LISTA 1, LËNDËT VEPRUESE SI MË POSHTË:

1. 1,4-Dimethylnaphthalene

2. 1-methyl-cyclopropene

3. Acibenzolar-s-methyl

4. Azoxystrobin

5. Bacillus subtilis (Cohn 1872) Cepi QST 713, identik me cepin AQ 713

6. Beflubutamid

7. Benthiavalicarb

8. Bifenazate

9. Boscalid (nicobifen)

10. Carfentrazone ethyl

11. Carvone

12. Cyazofamid

13. Cyflufenamid

14. Cyhalofop butyl

15. Diammonium phosphate

16. Dimethenamid-p

17. Dimoxystrobin

18. Etoxazole

19. Famoxadone

20. FEN 560

21. Ferric phosphate

22. Flonicamid (IKI-220)

23. Florasulam

24. Flufenacet (fluthiamide)

25. Flumioxazine

26. Fluopicolide

27. Fluoxastrobin

28. Foramsulfuron

29. Forchlorfenuron

30. Fosthiazate

31. Imazamox

32. Indoxacarb

33. Iodosulfuron

34. Iprovalicarb

35. Izoxaflutole

36. Kresoxim-methyl

37. Laminarin

38. Mepanipyrim

39. Mesosulfuron (Methyl)

40. Mesotrione

41. Metalaxyl-M

42. Methoxyfenozide

43. Metrafenone

44. Milbemectin

45. Penoxsulam

46. Pethoxamid

47. Picolinafen



48. Pinoxaden
49. Prohexadione (calcium)
50. Propoxycarbazonë
51. Proquinazid
52. Prosulfuron
53. Prothioconazole
54. Pseudomonas chlororaphis strain MA342
55. Pymetrozine
56. Pyraclostrobin (BAS 500 F)
57. Pyraflufen-ethyl
58. S-metolachlor
59. Silthiofam
60. Spinosad
61. Spiroxamine
62. Sulfosulfuron
63. Sulfuryl fluoride
64. Trifloxystrobin
65. Tritosulfuron
66. Zoxamide

Gjithsej: 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) lëndë vepruese.

### VENDIM

Nr. 20, datë 20.1.2021

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT  
TË BORDIT TË ERE-s NR. 122, DATË  
29.7.2019, “MBI MIRATIMIN E  
DRAFTKONTRATËS, NDËRMJET KESH  
SHA DHE OSSH SHA PËR  
SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE, QË  
REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË  
KËRKESËS SË KLIENTËVE QË  
PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI  
UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E  
HUMBJEVE NË RRJETIN E  
SHPËRNDARJES, PËR PERIUdhËN  
KOHORE 1.1.2019–31.12.2019”**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, pika 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 15 dhe

26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 13/4 prot., datë 19.1.2021, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 122, datë 29.7.2019, vendosi miratimin e kontratës ndërmjet Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019, sipas detyrimeve ligjore në fuqi.

- KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. nuk kanë negociuar dhe dakordësuar ende një draftkontratë të re për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2021, e cila do të duhet të miratohet nga ERE.

- Në të njëjtën kohë nuk rezulton të jenë konstatuar kontestime nga palët në lidhje me zbatimin e kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Lënie në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.7.2019, “Mbi miratimin e draftkontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”, deri në paraqitjen e draftkontratës së



re nga KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. dhe miratimin e saj nga ERE.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë , KESH sh.a. dhe OSSH sh.a., mbi vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 1.1.2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**







*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë